# DËSHMI ARKIVI

**A-463064**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ngërçi politik në Kosovë, Kushtetuesja rrëzon PDK-në: Votimi i qeverisë është i rregullt |
| ADRESA | `https://kohajone.com/kosova/ngerci-politik-ne-kosove-kushtetuesja-rrezon-pdk-ne-votimi-i-qeverise-eshte-i-rregullt/` |
| BURIMI | kohajone.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:56:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 13:27:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `776350a373c25d6bf492e6f7a40959bd6eb6b949475ef96ac79c01e185bd6c4c` |
| TEKSTI | `5b1a8889cc9f2e0d9311199d4d677fdd7c8dd5a8c71f50877f0bddd02de8e2f4` |
| PAMJA | `63ec8d4e15e785d3d191587492a8daaa6638a5a1f7753f9b843aa9fcacddf889` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `88acecd936386e4b4826927efa2b1edde856a5881aec48bcc82baffcaf27b300` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/88acecd936386e4b4826927efa2b1edde856a5881aec48bcc82baffcaf27b300`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ngërçi politik në Kosovë, Kushtetuesja rrëzon PDK-në: Votimi i qeverisë është i rregullt

KOSOVA E MËRKURË, 23 SHTATOR 2026 15:27




Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se Kuvendi i Kosovës është konstituuar përtej afatit 30-ditor, por megjithatë shtoi se deputetët duhet të zgjedhin nënkryetarin e dytë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Në njoftim, gjykata më e lartë në vend po ashtu tha se Qeveria e re e Kosovës është zgjedhur në përputhje me Kushtetutën. Gjykata tha po ashtu se afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht dhe përfundon më 6 tetor.

**Vendimi i plotë**




Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, më 23 shtator 2026, vendosi lidhur me kërkesat e bashkuara KO256/26 dhe KO258/26, në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së "Vendimit nr. 11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit", si dhe "Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës", të parashtruar nga: KO256/26, Arian Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe KO258/26, Arian Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata, njëzëri, vendosi:

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që Kuvendi i Republikës së Kosovës është konstituuar pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

III. TË KONSTATOJË që kalimi i afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka për pasojë fillimin e rrjedhjes së afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, kur posti i Presidentit është vakant dhe për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas neneve 86 [Zgjedhja e Presidentit], 95 [Zgjedhja e Qeverisë] dhe nënparagrafëve 1 dhe 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet që sa më parë të zgjedhin Nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar, në pajtim me paragrafin 3 të

LAJMET KRYESORE


Kur sekretet e shtetit përfundojnë në krevatin e biznesmenit


Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetformuese!


Sekretet e Vlora Hysenit për biznesmenin, eksperti i sigurisë: Korrupsion apo spiunazh, kjo çështje është tërmet


"Kush na e bëri këtë, duhet të paguajë", bisedat e Vlora Hysenit me Ergys Agasin. SPAK dyshon për lidhje personale


Debate PD – PS te Komisioni i Ligjeve për arrestin e Vlora Hysenit. Korreshi: O bosa, ka rënë shteti

TË PËRZGJEDHURA


1 Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...


2 Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude


3 Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...


4 Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"


5 Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar...

MË TË LEXUARAT

nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që Vendimi [Nr. 11-V-007] i 13 shtatorit 2026 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk është në kundërshtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

VI. TË KONSTATOJË që afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, sipas nënparagrafit 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka filluar më 8 gusht 2026 dhe përfundon më 6 tetor 2026;

VII. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

IX. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

X. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.


ETIKETA GJYKATA QEVERIA KURTI

## MË SHUMË NGA KOSOVA



**Kosova drejt zgjedhjeve nëse Presidenti nuk zgjidhet deri më 6 tetor**



**Dita e 7-të e protestës në Prishtinë kundër vendimit nga Haga për ish...**



**"Beteja s'ka mbaruar", djali i Hashim Thaçit: Vendimi na ...**



**PDK çon Kuvendin e Kosovës nismën për ndryshimin e ligjit për Gjykatë...**



**Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës në Prishtinë, sh...**



**Policia paralajmëron masa ndaj vozitjeve të rrezikshme në Kosovë**

## LAJMET E FUNDIT



**Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë!**

12 MINUTA MË PARË




**Shpëtim Aliu kapet në Rusi, koordinator i grupeve kriminale shqiptare**

13 MINUTA MË PARË




**Berisha ngre akuzat për Vlorën Hyseni: SPAK e mbron, nuk e cilëson pjesë të grupit kriminal**

17 MINUTA MË PARË









116 ditë protestë, Sidorela Vatnikaj: Nga Agasi te Tahiri, korrupsioni është bërë me urdhër të Ramës
38 MINUTA MË PARË

Vengu mohon akuzat e Ahmetajt për trafik ar*ësh: Të pabazuara dhe të ekzagjeruara. Shteti shqiptar nuk negocion në hije
40 MINUTA MË PARË

116 ditë protestë, Arben Kola thirrje SPAK: Vepro me dorë të hekurt ndaj çdo politikani që ka vjedhur shqiptarët
53 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta **"KOHA JONË"** themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT
LAJME
SPORTI
EKONOMI
EDITORIAL
WEBTV
AKTUALITET
RAJONI
KOSOVA
BOTA
TEKNOLOGJI
SHOWBIZ
SHËNDETI
SOCIALE
TURIZËM
KURIOZITETE
KULTURA
HISTORIKU
KONTAKT

**BOTUES & DREJTOR:** Nikoll LESI
**KRYEREDAKTOR:** Daniel MUÇAKU
**ZV/KRYEREDAKTOR:** Redjon SHTYLLA
**BORDI:** Elsa KAMBERI, KRYETARE
**NIPT: J71425013C**

NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.